



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Nënkomisioni për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas
Aleanca e Grave Deputete*

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.10.2020, ora 14:00

Drejtojnë mbledhjen:

**Eglantina Gjermeni – kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe
Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas**

Elona Gjebrea – kryetare e Aleancës së Grave Deputete

Rendi i ditës:

Mbledhje e përbashkët e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas dhe Aleancës së Grave Deputete me temë: “Barazia gjinore dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) – matja e efikasitetit e arritjes së integritetit të barazisë gjinore dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs)”

Marrin pjesë:

Eglantina Gjermeni, Klodiana Spahiu, Elona Hoxha Gjebrea, Amra Barova, Musa Ulqini, Rudina Hajdari, Antoneta Dhima, Ediola Braha, Elona Gjebrea, Vasilika Hysi, Ardiana Jaku, Senida Mesi, Klotilda Bushka, Ermonela Felaj, Milva Ekonomi, Almira Xhembulla, Majlinda Halilaj.

Të ftuara:

Miranda Ostrosi (Veliaj) – Koordinatorë Kombëtare e OSBE-së në Shqipëri

Sihana Nebiu – Shefe e Departamentit të Demokratizimit në Prezencën e OSBE-së në Tiranë

Fioralba Shkodra – Përfaqësuese e Zyrës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Miranda Ostrosi – Unë ju falënderoj që gjetët kohën, pasi e dimë që është një periudhë e ngarkuar dhe të gjitha ju keni shumë angazhime. Ne do të mundohemi, në qoftë se do të jetë e nevojshme, të mund të akomodojmë çdo kohë tuajën, kur e keni pak të lirë, për të ndërmarrë aktivitete të tilla mbështetëse. Kështu që mos na kurseni. Kur e them këtë, e them në emër të ekipit tonë që jemi këtu sot. Jemi një ekip i bashkuar, OSBE-ja dhe zyra e UN-it në Tiranë. E falënderoj Fiorin në shenjë mirëseardhjeje, në, fakt, je në familjen tënde, Fiori!

Do të doja që t'ia kaloja fjalën direkt Sihanës edhe për fillimin, por edhe për të dhënë një informacion të shkurtër për pjesën e qëllimit të aktivitetit dhe si do të vazhdojë.

Nuk e di nëse ka diçka tjetër nga juve, Elona.

Elona Gjebrea – Jo, jemi në rregull. Presim t'ju dëgjojmë ju.

Faleminderit!

Sihana Nebiu – Faleminderit, Elona!

Faleminderit, Miranda!

Shumë shkurtimisht, se nuk do të ndalem aq shumë në pjesët e përgjithshme, për shkak se jam e vetëdijshme se të gjithë jemi me kohë të limituar, ndaj do të mundohemi ta kemi një *briefing* sa më konçiz dhe të jepen sa më shumë informacione. Thjesht qëllimi i *briefing*-ut të sotëm është për instrumentet, të cilat e lejojnë integrimin e perspektivës gjinore në punën e Kuvendit dhe, në të njëjtën kohë, *gender mainstreaming*-un dhe *SDG mainstream*-in, dy aspekte të cilat Kuvendi i ka në kuadër të veprimtarisë së tij.

Edhe një herë, gjej rastin të falënderoj zyrën e UN-it dhe Fiorin që ishin të gatshëm t'i bashkoheshin takimit të përbashkët të sesionit dhe t'i përmbledhim të dyja informatat në të njëjtën kohë. Përderisa ne kemi në aspektin e integritit të perspektivës gjinore, Fiori do ta mbajë më shumë në aspektin e integritit të perspektivës së SDG-së të UN-it në punën e Kuvendit.

Po kaloj drejt te prezantimi dhe po nis me *Powerpoint*-in që të jetë pak më vizuale. Gjithsesi, do të kisha dashur t'ju them se është hera e parë që e mbaj këtë trajnim në gjuhën shqipe. Kështu, të gjithë vokabularin e kam gjithmonë në anglisht. Në qoftë se ndalem apo nuk mund të shprehem, paraprakisht kërkoj ndjesë për të. Uroj të mos ndodhë, por kjo është... Kërkoj ndjesë!

E dyta, në çdo moment që do të keni pyetje apo komente, mund të ndalemi lirisht ta lidhim sa më shumë me punën e përditshme të Kuvendit dhe me përditshmërinë tuaj. Nuk e di nëse duket tani. Besoj se *Powerpoint*-i paraqitet tek të gjithë.

Pjesa e parë që do të kisha dashur të kalojmë, është koncepti i integritit të perspektivës gjinore apo i *gender mainstreaming*-ut, sepse është i rëndësishëm, dhe cilat janë avantazhet.

Faktikisht, një prej avantazheve, të cilat i përkasin integritit të perspektivës gjinore, është se i vendos njerëzit në qendër të politikëbërjes dhe nxjerr në pah efektet e politikave mbi jetën e qytetarëve; mundëson udhëheqje më të mirë dhe më të informuar; përfshin si burrat, ashtu edhe gratë në të gjitha nivelet e punës dhe përfiton maksimalisht nga potenciali i të gjithave. Domethënë, nuk mundëson vetëm përfshirjen e grave, por gjithmonë merr perspektivën e të dyja palëve: edhe të burrave, edhe të grave. Ajo është shumë e dukshme në të gjithë procesin.

Tjetër aspekt, në kuadër të OSBE-së dhe *gender mainstreaming*-ut në konceptin e përgjithshëm të punës së OSBE-së. Këtë nuk e hoqa, po e mbaj këtu, për shkak se edhe Kuvendi i ka njësoj. Domethënë, OSBE-ja ka si qëllim sigurinë gjithëpërfshirëse, e cila ndahet në komponentët e stabilitetit politik, prosperitetit ekonomik dhe drejtësisë sociale, të cilat mund të arrihen vetëm nëse ka qasje të barabartë në resurse, shërbime dhe mundësi të barabarta si për burrat, ashtu edhe për gratë, për minoritetet, për popullsinë rurale dhe urbane, për personat me nevoja të veçanta. Pra, kur ka një përfshirje të të gjithëve në këtë proces, vetëm atëherë krijohet paqja dhe siguria e qëndrueshme, që do të jetë.

Integrimi i perspektivës gjinore apo *gender mainstreaming*-u mundëson si strategji apo si metodë arritjen e barazisë gjinore, ndihmon si procesin e vlerësimit të implikimit dhe të gjitha politikat, veprimet dhe aktivitetet se çfarë implikimi ka ndaj grave dhe ndaj burrave. Kjo nuk është vetëm një sekuençë e punës, por është gjatë gjithë përpilimit, që nga fillimi, te planifikimi, te implementimi, te monitorimi dhe deri te vlerësimi. Kështu që, si metodë *gender mainstreaming* siguron që nevojat, eksperiencat e grave dhe burrave janë të integruara që nga dizajnimi, fillimi dhe kalon në të gjithë fazat. Ky proces gjithmonë e ka fokusin te vlerësimi, nëse gratë dhe burrat përfitojnë në mënyra të barabarta në këtë proces. Është pjesë e gjithë amendimeve dhe intervenimeve, duke përfshirë stafin, procedurat dhe kulturën organizative, si dhe programet, projektet, aktivitetet dhe intervenimet që janë.

Domethënë, shpeshherë integrimin e perspektivës gjinore e shohim në aktivitet apo veprimtarinë, efektin e asaj pune që jemi duke bërë, sepse *gender mainstreaming* duhet të ketë parasysh edhe sesi është përfshirë brenda stafit. Domethënë, nëse kemi aktivitet apo çështje, të cilën e trajtojmë dhe është për të drejtat e grave, përderisa ekipi që merret me atë aktivitet janë vetëm burra apo vetëm gra, përsëri nuk kemi përfshirje të të dyja anëve, pra duhet të jemi të vëmendshëm që edhe përfshirja e stafit apo procedurat operative që realizohen, të kenë një balancë edhe të merren parasysh aspekt e integritit të përkatësisë gjinore.

Kështu që, në këtë pjesë luan rol shumë edhe kultura organizative. Domethënë, mund të flasim për *gender mainstreaming* gjatë, por përderisa nuk e bëjmë brenda, është shumë më vështirë të implementohet edhe të bëhet jashtë.

Një ndër pyetjet ishte se kush është përgjegjës për *gender mainstreaming*. Zakonisht, ndodh që kërkohet një person, i cili do të jetë përgjegjës dhe do të drejtojë *gender mainstreaming*. Ky është një ndër faktorët që do të dështojë, sepse *gender mainstreaming* nuk mund të qëndrojë apo të jetë obligimi i një personi, apo një pozite, apo disa pozitive. *Gender mainstreaming* apo qasja se kush duhet të merret me të, duhet që të jenë të gjithë të jenë përgjegjës për integrimin e saj, vetëm atëherë mund të ketë efekt në punën që do të realizohet.

Flasim për barazinë gjinore dhe integrimin e barazisë gjinore në punë. Si moment të veçantë sivjet kemi COVID-in dhe situata që u krijua prej COVID dhe si ndikon në marrëdhëniet gjinore apo në aspektin e punës së përgjithshme. COVID-i ndikoi në mënyrë disproporcionale në aspektin e barazisë gjinore në Shqipëri, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në shëndetsi dhe në aksesin në shërbime. Kujdesi pa pagesë ndaj grave, domethënë kujdesi ndaj familjes, fëmijëve, të moshuarve, u rrit shumë më shumë sesa në kushtet normale. Dhuna me bazë gjinore u rrit, grupet e marginalizuara ishin në pozitë edhe më të marginalizuar se më parë. Domethënë, në situata krize rritet më shumë hendeku i barazisë gjinore dhe është e nevojshme që të jemi më shumë të vëmendshëm sesi politikën, apo paket, apo intervenimet që planifikohen të ndikojnë në shoqëri, por duke marrë parasysh edhe ndikimin individual në grupet e ndryshme.

Gjithmonë flasim për barazi gjinore dhe si e integrojmë, por gjithmonë ka dy qasje të barazisë gjinore. E para është integrimi i perspektivës gjinore, e cila është komplementare dhe kjo nuk është specifikisht për barazinë gjinore. Kjo ka të bëjë me të gjitha politikën, qoftë shëndetësi, qoftë ekonomi, qoftë siguri, domethënë të gjitha aspektet duhet ta kenë perspektivën gjinore të integruar. Pra, nuk duhet të ketë një aspekt specifik, por të gjitha lidhjet të mund të analizohen në aspektin e perspektivës gjinore.

Ndërsa qasja e dytë është e përqendruar dhe ka për qëllim barazinë gjinore. Ligji kundër dhunës me bazë gjinore, për shembull, është veprim i përqendruar për shkak se ka për bazë gjininë edhe raportet, edhe ndikimet janë gjini. Gjithashtu, përderisa paket e ndihmës gjatë COVID-it nuk kanë për qëllim të përkrahin vetëm gratë, por të gjithë popullatën, përderisa bëhet analiza sesi ndikon te gratë dhe te burrat, atëherë kemi qasjen e parë, e cila është integrimi i perspektivës gjinore në një intervenim gjeneral.

Gjithmonë dua të përgëzoj Kuvendin, për planin e barazisë gjinore që u aprovua muaj më parë. Disa nga komponentët, për të cilat zakonisht flas, i hoqa për shkak se ishin veçmas të aprovuara dhe të kaluara nga plani.

Zonja Gjermani, më duket se votuat tjetrën, kështu që jemi të qartë.

Plani i barazisë gjinore gjithmonë duhet të përfshijë minimumi 3 shtylla të punës, të cilat mundësojnë që barazia gjinore të arrihet në mënyrë sa më efektive dhe eficiente. Ajo është integrimi i perspektivës gjinore brenda strukturave të Kuvendit.

Gjatë takimit që u zhvillua në Pogradec vitin e kaluar u bisedua edhe për mënyrën se si funksionojnë strukturat kur caktohen seancat, sa është orari i punës, sa parlamenti është i ndjeshëm për pjesëmarrjen dhe dedikimin e grave, nëse i trajton në mënyrë të barabartë gratë dhe burrat, por jo në mënyrë direkte. Për shembull, nëse seancat zhvillohen shumë vonë, prindërit kanë obligime dhe veçanërisht nënat pritet të jenë në shtëpi, atëherë ka implikime dhe shtohet stresi. Ky është një shembull shumë i vogël për të treguar se si barazia gjinore trajtohet brenda strukturave të Kuvendit me stafin e Kuvendit, por edhe me procedurat e përgjithshme. Pastaj, kjo është në politikat, programet dhe veprimet, të cilat kanë të bëjnë me pjesën e jashtme. Këtu vijnë ligjet, raportet, puna e komisioneve dhe çdo gjë që del si *output* prej parlamentit.

Shtylla e tretë është që gjithmonë duhet të ketë tema të caktuara prioritare. Kjo do të thotë që e koncentrojnë të gjithë energjinë që të adresojnë një problem të caktuar, i cili ka të bëjë me barazinë gjinore. Kjo ishte një përfshirje e gjerë e konceptit dhe se si mundësohet ambienti i volitshëm në të cilin barazia gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore është i mundur të realizohet në mënyrë efektive dhe eficiente.

Për të arritur këtë gjithmonë na duhen instrumente, të cilat na ndihmojnë që ta integrojmë, por në të njëjtën kohë edhe të shikojmë se si është integruar dhe se si mund të përmirësohet. Njëra prej fotografive që zakonisht e përdorim, shkruan se kjo është në të gjitha sferat e jetës. Kjo tregon sa pengesa kanë gratë zakonisht në punën e tyre profesionale. Nëse dikush mund ta ketë rrugën pak më të hapur, të tjerët kanë detyrat e shtëpisë, hekurrosjen, gatimin, kujdesin, që gjithmonë të paraqesin pengesa në punën e mëtejshme. Edhe pse flasim për meritokraci me kritere të njëjta, e shikojmë që rruga nuk ka qenë e njëjtë për të gjithë.

Për sa u përket instrumenteve, të cilat ndihmojnë që barazia gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore të jetë efektive, ajo kalon nëpërmjet disa instrumenteve, si: indikatorët gjinorë, përdorimi i matësit gjinor, analiza gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore gjatë gjithë ciklit, që u përmend më herët, që nga planifikimi, zhvillimi, implementimi, monitorimi dhe vlerësimi, përpilimi dhe përdorimi i udhëzuesit për veprimtarinë që bëhet, që mund të jetë

në komisione të ndryshme, apo përdorimi i gjuhës me ndjeshmëri gjinore. Edhe kjo ka ndikim shumë të lartë se sa sukses ka i gjithë intervenimi. Domethënë, prej momentit që fillojmë të tregojmë kujdes se si e përdorim gjuhën dhe sa e ndjeshme është gjuha që përdorim, atëherë aq më lehtë e kemi të shikojmë se si reflektohet ajo në punën e mëtejshme.

Në lidhje me indikatorët me ndjeshmëri gjinore, gjithmonë parashtrijmë qëllime apo indikatorë, të cilët na tregojnë nëse ka pasur apo jo sukses puna jonë. Në momentin që e plotësojmë indikatorin, ai na tregon se kishim kaq përqind sukses, në bazë të asaj që planifikonim në fillim. Gjithmonë indikatorët *smart* duhet të jenë të matshëm në kohë të caktuar.

Pra, cilët janë indikatorët që do të ndihmojnë të transformohen indikatorët, të cilët janë me ndjeshmëri gjinore? Ajo që e mundëson një indikator të jetë me ndjeshmëri gjinore, është indikatorin që do të përmbajë të dhëna, të cilat janë të ndara sipas gjinisë, moshës dhe gjendjes socio-ekonomike. Domethënë, nëse themi se kemi përfitues të paketës ekonomike që u jepet si ndihmë gjatë periudhës së Covid-it, në momentin që të dhënat e brendshme, që jepen si problem, janë të ndara në bazë të gjinisë, sa gra dhe sa burra përfituan, atëherë është shumë më lehtë të integrohet perspektiva gjinore. Në të njëjtën kohë, është mosha dhe gjendja socio-ekonomike.

Indikatorët janë të dizajnuar të paraqesin ndryshimin në relacion burra dhe grua në shoqëri në periudha të caktuara kohore. Domethënë, të tregojnë çfarë është pritja nga fillimi deri në fund dhe si pritja është dinamika sesi është në grupin e grave dhe në grupin e burrave, pastaj është si mjet, i cili bën vlerësimin e progresit të intervenimit të caktuar në drejtim të arritjes së barazisë gjinore apo të dhëna, të cilat janë të ndara sipas gjinisë, ndihmojnë të shihet nëse gratë dhe burrat janë të përfshirë në proces edhe si staf, edhe si përfitues në të gjitha nivelet. Domethënë, nuk përçojnë vetëm intervenimin dhe efektet që arrihen nga intervenimi, por edhe kush ka qenë i inkuadruar në atë proces dhe mundëson monitorimin e vlerësimin efektiv. Që nga fillimi kemi indikatorët, të cilët janë ndarë në dy grupe, burra edhe gra dhe në fund mund të shohim se sa për qind kanë përfituar gratë apo sa e suksesshme ka qenë në mesin e grave dhe sa e suksesshme ka qenë në mesin e burrave, flas për ato të integruara, jo specifike apo *target detection*.

Një instrument që mundëson të arrihet kjo është *gender marker* apo matësi i barazisë gjinore, i cili mat trendin, por si matës asnjëherë nuk është preciz, por jep më shumë një indikacion se ku gjendet apo çfarë shkalle është. E matëm shkallën e integritit të perspektivës gjinore, që është edhe në nivel të veprimtarisë apo aktivitetit, edhe në aspekt operacional gjatë procesit sesi është sot, pra se në çfarë shkallë perspektiva gjinore është e integruar në financë,

a ka buxhet të vogël, nuk ka aspak buxhet, ka pak buxhet, ka buxhete të vogla në vende të ndryshme apo ka një buxhet të integruar, i cili është i dukshëm.

Gender marker ndahet në 4 grupe. Matësi i parë quhet zakonisht zero dhe tregon që intervenimi nuk ka asnjë kontribut ndaj barazisë gjinore. Nuk është bërë analiza e problemit duke marrë perspektivën gjinore, domethënë nuk është bërë matja sesi ndikon politika te gratë dhe si ndikon politika te burrat, ose, së paku, kjo nuk është e reflektuar në punën, bisedën, raportet dhe në ligj, prandaj quhet *blind*, domethënë totalisht nuk merret parasysh. Mund të ketë në vetvete, por në lexim, dukje apo diskutim pjesa e barazisë gjinore është totalisht e padukshme.

Gender marker 1: intervenimi ka kontribut të limituar në barazinë gjinore, ose është i integruar vetëm si numër pjesëmarrësish, që do të thotë se nuk hyn në përmbajtjen se si ndikon kjo te gratë dhe te burrat, por thjesht tregon numrin e pjesëmarrësve, domethënë është shumë sipërfaqësore.

Grupi i tretë quhet *gender marker 2* dhe është intervenimi që ka për qëllim përmirësimin e barazisë gjinore dhe perspektiva gjinore është marrë parasysh gjatë gjithë projektit, domethënë që nga analiza e situatës, përcaktimi i qëllimit, intervenimi, i cili analizon dhe merr parasysh ndikimin që ka në përmbajtje, jo vetëm në sipërfaqe.

Grupi i katërt quhet *gender marker 3* dhe është intervenimi që ka fokus primar barazinë gjinore. Zakonisht pyetja është se cili është më i rëndësishmi, 2 apo 3. Gjithmonë përgjigjja është ose njëra ose tjetra, por përgjigjja e saktë është se të dyja janë të rëndësishme. Nëse ju kujtohet fotografia, pra rruga e grave në punë nuk është e hapur dhe ka pengesa, intervenimi, i cili njihet si *marker 3*, është intervenimi që mundohet t'u heqë pengesat e grave, t'ua hapë rrugën dhe të jenë me baza të njëjta që të konkurrojnë dhe të kenë mundësi e hapësira të e njëjta si burrat. Ndërsa *marker 2* është trajtimi i barabartë i grave dhe burrave që të kenë mundësi të barabarta. Kështu që 2 dhe 3 janë gjithmonë të barabartë për nga rëndësia në të gjithë procesin, përderisa zeroja është ai që gjithmonë mundohemi t'i ikim me çdo kusht, për shkak se nuk ka asnjë mënyrë që t'i sjellë dobi as procesit dhe as produktit, i cili prodhohet.

Marker 1 është shumë sipërfaqësor, është “sa për sy e faqe”, zakonisht them: “dakord” në fund sa për të përmirësuar shijen, por nuk është ajo. Gjithmonë ideja është që gjithë puna të vlerësohet me markerin 2 apo 3.

Dua të ndalem dhe të pyes a keni pyetje apo komente në lidhje me këtë, para se të vazhdoj?

Dakord. Besoj se ishte e qartë edhe pse kalova shumë shpejt të gjithë materialin.

Pjesa e fundit është se si e gjithë kjo kalon në ciklin në të cilin bëhet identifikimi i nevojave, zhvillimi i produktit, implementimi dhe vlerësimi, monitorimi dhe vlerësimi.

Nëse në të gjithë këto faza, në të cilat kalon cikli i një ligji, produkti i punës, monitorimi, e ka perspektivën gjinore që nga fillimi, është shumë lehtë të arrihen rezultate, të cilat janë të dukshme dhe mund të raportohen në mënyrë shumë të lehtë më tutje dhe të paraqiten si suksese.

Domethënë, në momentin që gjendemi, integrimi i barazisë gjinore mundohet të vendoset në fazën e monitorimit dhe vlerësimit, përderisa nuk është marrë parasysh në tri fazat e mëparshme, është shumë vështirë të paraqesë në mënyrë objektive situatën.

Kështu që është e mundshme, edhe atë zakonisht të gjithë e bëjnë, po thjeshtë se nuk e jep rezultatin dhe nuk arrihen efektet e duhura, përderisa, nëse përdoret në të gjithë fazat, është shumë lehtë dhe nuk kërkon ekstra as energji, as punë ekstra për të raportuar arritjet dhe se si ndikon i gjithë procesi në perspektivën gjinore.

Me qaq unë e përfundoj pjesën e markerit dhe instrumenteve të barazisë gjinore. Nëse keni pyetje mund t'u përgjigjem.

Elona Gjebrea – Faleminderit për prezantimin dhe informacionin Sihana!

Asnjëherë nuk janë të tepërta trajnimet apo informacionet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.

Mendoj se mund të ketë vlerë, jo për tani, por ndoshta duke na e shpërndarë në formën e një materiali, që mund ta keni dhe ka të bëjë me leksionet e marra nga vendet e ndryshme për sa u përket këtyre katër niveleve.

Pra, një mosfunksionim i nivelit të parë, siç e përmendët edhe ju, ka bërë të dështojë hallka e zinxhirit. Mbase, në qoftë se ne marrim ndonjë informacion se si vende të ndryshme kanë performuar për sa i përket matësit të barazisë gjinore apo në qoftë se ka vëzhgime të tilla, mund të ndihmonte që edhe ne të kuptonim pak më mirë pjesën e realitetit shqiptar në kontekstin e vendeve të tjera.

E dyta, meqenëse koleget janë futur në kohë të ndryshme dhe unë nuk mund t'i shikoj dot të gjitha në ekran, dëshiroj t'i falënderoj të gjitha zonjat deputete, pjesë të Aleancës, që megjithëse kanë angazhime gjetën kohë të jenë pjesë e këtij trajnimi të planifikuar prej kohësh.

Faleminderit!

Sihana Nebiu - Faleminderit!

Kam një koment të shkurtër. Markerit momentalisht fillon të përdoret në të gjithë organizatat, si ndërkombëtare, në bizneset dhe në të gjithë format e ndryshme për shkak se sjell *edit value*, domethënë jo domosdoshmërisht projekti nëse është zero do të dështojë, ndoshta do të arrijë, pra nëse potenciali është 100%, nëse nuk është përdorur markeri, mund të arrihet deri

në 60-70%, ndërsa me integrimin e perspektivës gjinore arrihet shumë më shumë rezultat me qasjen e njëjtë, resurset e njëjta dhe punën e njëjtë.

Vetë OSBE-ja, që nga ky vit markerin e ka obligativ në të gjithë aktivitetet dhe proceset, domethënë nuk e ka vetëm në programet të cilat realizojmë, por në të njëjtën kohë e ka edhe në procedurat e brendshme dhe në nivel operacional, domethënë nëse është paneli, sa gra dhe sa burra janë apo intervenimi për këshillat e sigurisë në nivel lokal, se si i analizojmë problemet e grave dhe si i analizojmë problemet e burrave, fillojmë ta ndajmë, se zakonisht e marrim si aktivitet të përgjithshëm dhe nuk hymë në analiza të thella se si ndikon te gratë dhe si ndikon te burrat. Kjo gjë ka qenë gjithmonë si rekomandim, por nuk ka qenë obligative. Nga sivjet është obligative që në të gjithë aktivitetet, edhe raportimet, edhe planifikimet e projekteve është integrimi i markerit gjinor, në të njëjtën kohë kalon edhe në integrimin e buxhetit.

Gjithsesi, do të mbledh materiale, por nuk shoh që shumë vende apo shumë parlamente janë duke i implementuar veç vendeve të zhvilluara, por implementimi i *gender marker*-it dhe përdorimi i instrumenteve nuk kushton pothuajse asgjë as në kohë, as në resurse, vetëm ka nevojë për adaptimin e mënyrës sesi operohet. Nëse krijohen që nga fillimi, nëse u jepet mandati komisioneve parlamentare, dhe jam shumë koshiente se në disa raporte të komisioneve, në veçanti Kuvendi i Shqipërisë, ka filluar ta bëjë analizën gjinore, kryesisht janë çështje të cilat janë *target detection*, jo të përgjithshme. Në momentin që merret si vendim që të implementohet tek të gjitha komisionet, në të gjitha raportimet dhe në të gjitha informacionet që mblidhen, atëherë normalisht mund të ulemi e të zhvillojmë qasje specifike apo instrumente specifike, çek-lista specifike, të cilat do të ndihmojnë të adoptohet mënyra e funksionimit që mundëson integrimin e barazisë gjinore.

Zonja Gjermani, është për mua, apo për komisionin tjetër?

Nuk ju dëgjoj, sepse e keni të mbyllur mikrofonin.

Eglantina Gjermani – Këtë radhë është për ju.

Shumë faleminderit për prezantimin!

Shumë faleminderit për organizimin e eventit, pa dyshim, falënderoj jo vetëm koleget e Aleancës, por edhe koleget dhe kolegët e komisionit që janë të pranishëm! Kërkoj ndjesë që m'u desh që paralelisht të jem edhe këtu, sepse kështu erdhi orari, u shty më shumë.

Lidhur me modelet se si ne si parlament mund ta përfshijmë integrimin gjinor në ligje apo në nisma të ndryshme që ndërmarrim, mendoj se manuali që ju na keni ndihmuar të përkthenim për *gender sensitive legislation*, pra si të hartosh një legjislacion në këndvështrimin gjinor, ka edhe modele në kuptimin e praktikave të mira të realizuara nga parlamente të ndryshme, ka edhe udhëzues apo hapa konkretë se si mundet që një projektligj, i cili, në dukje

nuk ka fare elemente gjinore apo perspektivë gjinore, duhet apo mundet të përfshihet perspektiva gjinore, duke analizuar se si ndikon te jeta e grave apo e burrave, se si i adreson pabarazitë gjinore që ekzistojnë, se si në mënyrë specifike mund t'i fuqizojë gratë për të arritur një balancë. Meqenëse flitet edhe te plani i aktiviteteve që kemi bërë, i gjithë manuali u është shpërndarë kolegëve. Ne kemi bërë një variant më të përmbledhur dhe më të shkurtuar. Unë mund t'ua nis të gjithë kolegëve gati që në momentin kur do të kemi në dorë projektligje të ndryshme, por edhe buxhetin, të kemi pyetje që mund t'i adresojmë për të nxjerrë në pah elementet e perspektivës gjinore dhe si mund t'i adresojmë në nisma ligjore.

Faleminderit!

Sihana Nebiu – Faleminderit shumë!

Në *Webex* për momentin po ju dërgoj *linkun* drejt dokumentit, i cili është në gjuhën shqipe, është një manual i cili jep shumë resurse, por qëllimi i ditës së sotme ishte vetëm një këqyrje dhe një reflektim sesi mund të vazhdohet më tutje dhe të zhvillohet me më shumë detaje.

Edhe një herë faleminderit shumë, zonja Gjermani për ndërhyrjen!

Po, zonja Spahiu. A mund ta aktivizoni mikrofonin, sepse nuk ju dëgjojmë?

Klodiana Spahiu – Ju falënderoj shumë për prezantimin dhe për organizimin!

Unë kam një propozim pak më konkret. Ne kemi bërë trajnime në lidhje me barazinë gjinore dhe me matësin e barazisë gjinore. Jemi munduar ta reflektojmë edhe vjet kur kemi kaluar buxhetin, por besoj jo në të gjitha komisionet.

Ju përmendët pak situatën e COVID-it. Nuk e di nëse mund të realizohet ndonjë gjë më konkrete në lidhje me një studim modest, për prekjën e grave nga COVID-i. Për shembull: sa gra e kanë humbur vendin e punës për shkak të situatës së pandemisë?

Një studim tjetër i vogël që mund të bëhet lokalisht, për shembull, në Durrës ose në Krujë: sa gra kryefamiljare e kanë marrë bonusin e qirasë, ose bonusin e qirasë që është shpërndarë në një numri të caktuar familjesh. Sa prej tyre kanë qenë gra kryefamiljare? Ose edhe për bonusin e rindërtimit, pra këto aspekte të fuqizimit të gruas në momente të vështira, siç jemi tani, për shkak të pandemisë. Si ka qenë mbështetja, ose realizimi i barazisë gjinore në këtë situatë të vështirë qoftë të COVID-it, qoftë nga pasojat e tërmetit? Pa dyshim që detyra jonë është që çdo gjë ta pasqyrojmë në projektligjet e ardhshme, por mendoj që, edhe nëse realizojmë një gjë konkrete, lokalisht do të ishte shumë mirë, gjithmonë me ndihmën tuaj, në bashkëpunim me bashkitë përkatëse.

Sihana Nebiu – Faleminderit!

Gjithsesi, ka shumë organizata të grave dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare, që kanë bërë hulumtime të vogla në tema të ndryshme, pasi që OSBE-ja udhëheq edhe grupin koordinues të organizatave të ndryshme, të cilat punojnë në lidhje me barazinë gjinore dhe gratë në vendimmarrje, të përcjellë edhe këtë mesazh aty, që të shohim nëse mund ta përmbledhim se kush ka bërë hulumtim dhe çfarë hulumtimi ka bërë. Kjo me qëllim që t'i mbledhim ato, për t'ju përcjellë juve. Gjithsesi, kjo është edhe një mundësi shumë e mirë për të parë se si mundemi, që në mënyrë strukturore, të arrijmë të integrojmë barazinë gjinore që nga planifikimi i intervenimeve ashtu e deri tek mënyra se si ndikojnë dhe si sjellin rezultate. Kjo duhet të jetë ashtu siç thamë, brenda gjithë ciklit të realizueshëm.

Faleminderit!

Fiori, po ta përcjell fjalën ty!

Fioralba Shkodra – Faleminderit! Edhe një herë, përshëndetje!

Unë e kam kënaqësi të flas për EDGE-të apo objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm me koleget, që janë jo vetëm kolege këtu, por më vjen mirë që janë edhe kolege në grupin e Aleancës së Grave në Kuvend. Kjo është diçka që ne e promovojmë fort në OKB, se kur flasim për barazinë gjinore...

Dëgjohem apo jo?

Në fakt, unë vij sot në këtë sesion me ju, sepse Diana bashkë me Mirën më ftuan, sepse do të flasim për barazinë gjinore. Detyrimisht, barazinë gjinore nuk mund ta konceptojmë ndryshe pa atë që quhet Axfhenda 2030 apo objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, sepse janë kthyer, le të themi, jo vetëm në terminologjinë e modës, që të gjitha vendet e botës përdorin nga 2015-a deri në 2030-ën, por edhe për rëndësinë që i japin konceptit të barazisë gjinore, në mes atyre shtatëmbëdhjetë EDGE-ve që ne do të përmendim.

Unë nuk dua të mbaj një prezantim të gjatë, sepse ju, kolegë, jeni të gjithë të informuar dhe keni qenë shumë të përfshirë me procesin e angazhimit si parlament, në lidhje me përkthimin e EDGE-ve në terma konkretë në Shqipëri.

Megjithatë, do të më lejoni që të jap dy-tre përcaktime, të cilat dua t'i diskutoj me ju. Do të mbetemi në terma të përgjithshëm, për sa i përket objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, por dua ta theksoj se këto EDGE, ne e nisëm së bashku me zonjën Hysi, e cila ishte promotorja e angazhimit si parlament. Pastaj e vazhduam me zonjën Mira, ndërsa tani jemi duke punuar me zonjën Mesi, e cila më parë ishte në pozicionin e zëvendësministres dhe i shihte gjërat si zëvendëskryeministre. Tani, në cilësinë e të qenit kryetare brenda Komitetit të Financave, që është i dedikuar për ne të gjithë, po gjejmë një mënyrë dhe një formë bashkëpunimi, me një projekt që është financuar nga Nju Jorku, ku përveç të tjerave do të

synojmë ta sjellim konceptin e EDGE-ve më afër planifikimit publik, objektivave buxhetore, e pse jo të përcaktimit të aspekteve të monitorimit e implementimit të tyre në terma zhvillimi të planifikimeve strategjike që bëhen nga qeveria, por dhe më tutje.

Kështu, nëse mundem, ta *share Power Point*-in. Ju lutem, më ndaloni sa herë që ta shihni të arsyeshme. Ideja është që unë po e nxjerr te kjo figura, e cila ka të bëjë me këto shtatëmbëdhjetë figura shumë të bukura. Kjo është një përmbledhje e atyre që përmenda. Pra, në 2015-ën koncepti i EDGE-ve nuk vjen OKB-ja, si të qenit një organizatë multilaterale, por vjen nga vendet anëtare. Pra, 193 vende anëtare të OKB-së u mbledhën të gjitha së bashku në 2015-ën dhe thanë: deri tani ne kemi punuar për të siguruar një nivel pak a shumë të qëndrueshëm në botë. A ia kemi arritur?

Kishte shumë dilema, sepse vendet anëtare të OKB-së kishin funksionuar sipas objektivave të zhvillimit... U pa se këto objektiva, sa ishin të mira, sepse kishin ndihmuar në shumë aspekte, kur flasim për barazinë, nuk ishin të aplikuara njësoj në të gjitha vendet e botës. Pra, u pa që vendet e zhvilluara kishin kapacitetin dhe forcën ekonomike e politike, që ta çonin përpara agjendën, por ndërkohë, vendet e varfra, sidomos flasim për Afrikën, e kishin të pamundur të fusnin konceptin e zhdukjes, jo të zhdukjes, por të zbutjes së varfërisë. E kishin të pamundur të diskutonin konceptin e edukimit nëntëvjeçar të detyrueshëm, dhe në të gjitha vendet e Afrikës kishte shumë *gap*-e s ai takon mirëqeverisjes.

Atëherë, si u veprua? OKB-ja zhvilloi një ushtrim apo një konsultim shumë të gjerë global, që mori kohën e shkurtër por edhe të gjatë të 300 mijë - 400 mijë qytetarëve në të gjithë botën, të cilët në forma të ndryshme konsultimi, dhanë idenë dhe thanë: prioritetet për ne, deri në 2030-ën, janë 17.

Po t'i shihni, janë këto 17 kutitë e vogla, që përkthehen në atë që sfidat ne i kemi tani, por duhet të jenë edhe për brezat tanë të ardhshëm. Kanë të bëjnë me faktin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky është një term, që jam e sigurt që ju e përmendi shumë në diskutimet parlamentare, por edhe kudo, që ka të bëjë me elemente të zhvillimit ekonomik. Pra, dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor ndërthuren bashkë për të krijuar atë koncept të qëndrueshëm, që quhet zhvillimi i qëndrueshëm.

Kjo ishte risia që solli Axfenda e re 2030. Përveç kësaj, koncepti i zhdukjes së varfërisë në të gjithë botën ishte një sfidë shumë e madhe, që vendet anëtare të.... (*Nuk kuptohet*) thanë që tani ne do të flasim të gjithë njëloj, pavarësisht se secili vend e vlerëson në mënyrën e tij se si do ta aplikojë këtë Axfendë ose si do ta arrijë. Koncepti universal i zhdukjes së varfërisë, i zhdukjes së urisë, i arritjes së një mirëqenie financiare dhe shëndetit të njerëzve,

flasim për një edukim kualitativ, dhe kështu me radhë të gjitha deri te objektivi 17, do të jenë prioriteti i të gjitha vendeve anëtare në vitin 2030.

Çështja tjetër që ngrihet në Shqipëri është shumë e drejtë. Ne folëm për integrimin europian dhe themi që përsëri kemi disa axhenda. Pra, synimi ynë dhe prioriteti numër një i Shqipërisë është integrimi europian. Si lidhet integrimi europian me Axhendën 2030? Këto janë dy procese dhe axhenda, të cilat shkojnë në simbiozë me njëra-tjetrën. Unë mund t'ju them si Gjermania, Danimarka, Mali i zi, Kosova ose vende të tjera, qoftë ato që janë të integruara dhe janë pjesë e BE-së, qoftë edhe ata që janë vende candidate, synojnë që të arrijnë pikërisht të njëjtat objektiva, që janë 17. Pra, sinergjitë ndërmjet këtyre vendeve janë shumë të ndërlidhura.

Si e lidh parlamentin me këto 17 objektiva? Ne thamë që në vitin 2015 u bë një deklaratë, e cila u përkthye në terma vendi dhe mbaj mend që, falë përkrahjes që patëm në atë kohë nga zoti Ruçi, zonja Vasilika dhe qeveria, ne arritëm të hartonim një deklaratë në Kuvendin e Shqipërisë. Një pjesë e deklaratës së Kuvendit të Shqipërisë është marrë nga deklarata e përgjithshme e vendeve anëtare. Po ta shihni këtu unë kam shkëputur vetëm një pjesë se sa i rëndësishëm është roli i parlamentit në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Në konceptin fillestar ne themi se është qeveria përgjegjëse për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Kanë burimet financiare dhe urbane, por, së pari, janë të detyruar që të punojnë për arritjen e këtyre objektivave. Ndërkohë që koncepti nuk është i tillë, sepse pikërisht thelbi i arritjeve të këtyre objektivave është gjithëpërfshirja. Pra, nuk mund të jetë përgjegjëse vetëm qeveria, parlamenti të luajë një rol thelbësor, kyç në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Pse? Sepse, siç e shihni edhe te deklarata që unë e kam shkëputur në *slide*, roli juaj ndryshon shumë nga qeveria. Ju nuk jeni vetëm ligjvënës, mund të jeni ligjvënës dhe jeni ligjvënës shumë të mirë, por nga ana tjetër ju jeni përfaqësues të popullit. Pikërisht, kjo axhendë flet për ato sfida, që qytetarët i ndiejnë mbi shpatullat e tyre. Ne flasim për sfida që kanë të bëjnë me objektivin 5, i cili ka të bëjë me barazinë gjinore. Ne flasim për sfida të zhvillimit, flasim për objektivin 16, i cili ka të bëjë me mirëqeverisjen dhe pushtetin e së drejtës. Por a mund të garantojë vetëm qeveria ose edhe aktorë të tjerë, pa pasur parlamentin, i cili ka dorën e të bërit jo vetëm ligje të drejta, por edhe të sigurojë që këto ligje të zbatohen dhe realizohen siç duhet?

Unë nuk dua të ndalem shumë te ky *slide*, sepse janë pikërisht ato arsye që unë dhashë, pra kërkesën e llogaridhënies, për pjesën e qeverisë që thashë më parë.

Unë do të ndalem vetëm te rreshti i fundit i slide-s, sa u përjigjeni ju Kombeve të Bashkuara dhe sa Kombet e Bashkuara duhet të angazhohen me ekonominë? Kjo është një

marrëdhënie e dyfishtë, dhe duhet të jetë e domosdoshme, sepse, siç thotë pjesa e fundit e slides, pa qeverisje të mirë nuk mund të ketë zhvillim njerëzor të qëllimshëm, pra koncepti i tri dimensioneve që thashë pak më parë, pa llogaridhënien e qeverisjes nuk mund të ketë qeverisje të mirë.

Së fundi, pa një parlament efektiv, nuk mund të ketë llogaridhënie. Kjo është një shprehje shumë e bukur. Kështu që vetëm ju, si parlament, mund të siguroni që qeveria qoftë në rang lokal ose qendror, të raportojë dhe të japë llogari ashtu siç duhet për arritjen e objektivave.

Unë nuk dua të ndalem shumë tek tri principet, të cilat e karakterizojnë Axhendën 2030. Ajo që mund të them për këto tri principe është ajo që përmenda: të qenit universal, pra te Axhenda 2030 koncepti i të qenit universal është koncepti i të mos lënit askënd pas. (*Nuk kuptohet.*) Këto principe janë principe bazë, që e karakterizojnë Axhendën 2030 nga LG-ja e parë deri te LG-ja e shtatëmbëdhjetë, por le ta lidhim në terma konkretë në parlamentin shqiptar. Çfarë do të thotë “Universalitet”? Ajo që ju thashë pak më parë, pra koncepti është që jo të gjitha vendet do të bëjnë të njëjtën gjë njësoj, sepse ne nuk mund të bëjmë të njëjtën gjë njësoj si Gjermania apo Danimarka, por kur flasim për gjithëpërfshirje, kur flasim për aplikimin e përgjegjësive, kur flasim për një koncept që është universal, pra kjo agjendë i përket qoftë qeverisë, qoftë parlamenti, por edhe sektorit privat.

Për shembull, për dy ditë ne do të kemi një forum, i cili do të organizohet nga *International Center of Commerce* në Shqipëri, ku do të jenë të ftuar përfaqësues të qeverisë, të parlamentit, përfaqësues nga OKB-ja dhe të biznesit. Biznesi është një ndër aktorët më kryesorë që mund të financojë qoftë te burimet financiare, por edhe te pjesa e konceptit, sidomos kur flasim për punësimin dhe për mjedisin, sepse janë elemente që nuk mund të arrihen pa pasur sektorin privat me vete.

Po pjesa e shoqërisë civile? Edhe pjesa e shoqërisë civile është e domosdoshme, sepse shoqëria civile, të cilën ne e quajmë sektori tipik, përveç jush që jeni në parlament, shikon si zbatohen politikat qeveritare dhe si arrihet te shtresat vulnerabël, pra janë pikërisht këto elemente që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen.

Pjesa e të mos lënit (*Nuk dëgjohet*) është një element shumë sensitiv. Ne, sipas konceptit këtu në Shqipëri nuk mund flasim për pjesën e fesë apo të kombësisë si elemente që mund të na diskriminojnë, por kur flasim për orientimin seksual, për barazinë gjinore, për elemente që kanë të bëjnë me vulnerabilitetin e të qenit person me aftësi të kufizuar e me radhë, të gjitha janë elemente që, duam apo nuk duam ne, ju si parlamentarë që jeni ulur aty si ligjvënës, por dhe ne e ndiejmë që pjesa e respektimit të të drejtave të njeriut nuk është ashtu siç duhet. Roli

që ju keni si parlament është pikërisht që të jeni sa më afër atyre që ju votojnë dhe kjo nuk duhet të mbetet vetëm në letër. Ju e dini shumë mirë, sepse tani jeni në terren dhe i shihni nga afër se çfarë problematikash kanë qytetarët, por është një realitet me të cilin përballemi dhe duhet ta mendojmë sa herë hartojmë një projektligj. Çështja është që ne si deputetë, kur miratojmë një ligj, duhet të shikojmë nëse është në përputhje me nevojat që kanë qytetarët? A bëni ju, këtë pyetje e kam për ju, kolegë deputetë, ndonjëherë konsultime publike? Ky është një fakt që unë e di, sepse e shoh që jeni shumë aktivë në mediet sociale, por a keni menduar ndonjëherë të bëni një *(Nuk dëgjohet)* kur hartoni një projektligj? *(Nuk dëgjohet)* është një mënyrë, një nga mjetet që mund të përdoret ndërmjet shumë të tjerash, sepse konsultimi publik është shumë i gjerë. Pra, ju jepni një njoftim dhe thoni: të vijmë grupet e interesuara për këtë projektligj që do të diskutohet në iks komision parlamentar. Çështja është po ai publiku i gjerë, sepse jo të gjithë i hapin rrjetet sociale, por ata që nuk kanë mundësi, a mund të kontribuojnë pikërisht për këtë projektligj apo a kanë mundësi ata qoftë edhe të sugjerojnë një projektligj?

Aty ka njerëz me aftësi të jashtëzakonshme aty jashtë, të cilët mendojnë se ka ligje që duhen miratuar në kuadrin e gjerë ligjor. A e keni menduar çështjen e të qenit sa më afër tyre nëpërmjet? A keni menduar ndonjëherë ju si parlament të hartoni një *e-platform*, atë që bën qeveria dhe thotë platforma për mirëqeverisjen? A keni menduar ndonjëherë ju si parlament që të ngrini një platformë që të jetë *e-platform for the Parliament*?

Ka shumë eksperiencë të mira në botë në këtë drejtim, pikërisht siç bëjnë disa qeveri për qeverisjen afër qytetarit, duhet ta bëni edhe ju. Një mundësi tjetër që më shkoi nëpër mend kur po lexoja disa materiale para disa ditësh, ju keni si të zgjedhur elektoralë nga partitë tuaja përkatëse, keni zyrat e partive, si Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, por a keni menduar që në zonat ku jeni të hapni zyra që të jenë zyra të përfaqësimit të qytetarëve të parlamentit, jo vetëm të partive. Ndoshta kjo mund t'ju duket e vështirë për vetë dinamikat dhe si është politika jonë në Shqipëri, por këto janë gjëra ku vende të shumta në botë hapin zyra të angazhimit të qytetarëve si parlament dhe ku deputeti shkon çdo javë, jo vetëm ju, por edhe deputetët e opozitës, në atë zyrë dhe diskutojnë me komunitetin për çështje të ndryshme.

Nuk po ndalem më shumë në këtë çështje, por thjesht te këto 4 rrotat që unë vura në këtë *slide*.

Ju thashë se roli i parlamentit është mjaft i rëndësishëm, madje do ta quaja kyç. Sa ndihet kjo në Shqipëri? Kjo është një pyetje ku përgjigjen e pres prej jush, nëse ju e ndieni veten solid në aspektin e kontributit tuaj si deputetë apo deputete në pjesën e arritjes së strategjive. Sa i rëndësishëm është roli që luani ju?

Ju, siç e thashë, keni rol përfaqësues, keni rol ligjberës, por ajo që është e rëndësishme është edhe fakti që ju keni rol mbikëqyrjeje. Këtë rol ju mund ta bëni më së miri, siç e bëni shumë mirë deri tani. E keni të gjithë forcën, që ua jep mandati juaj si deputetë, që të thërrisni të gjitha autoritetet qoftë lokale, qoftë qendrore të raportojnë dhe të thonë ku janë me ...*(Nuk kuptohet)*

Unë mund t'ju them vetëm disa shifra. Deri tani shifrat që ne marrim nga buxhetet që vihen në dispozicion të SDGs-ve që kanë të bëjnë me shëndetin, që kanë të bëjnë me xhendër apo me edukimin janë nën 3%, ndërkohë që flasim për nivelet europiane, të cilat shtojnë 10, 11 % nivel buxhetor, që u jepet nga shteti në arritjen e këtyre objektivave.

Kemi indikatorë apo tregues, të cilët mund të na matin suksesin e arritjeve të SDGs-ve. Deri tani, sipas INSTAT-it, sipas një analize që kemi bërë si OKB, kemi vetëm 40%, pra kjo nuk do të thotë që jemi keq, absolutisht, kjo do të thotë se ne si tregues makro-ekonomikë, ekonomikë, të disagreguar apo jo, kemi vetëm 40% të matshëm, pjesa tjetër ose nuk janë të matshëm, ose ne nuk i matim për një arsye apo një tjetër.

Roli juaj si parlament më bën të mendoj që jo vetëm te pjesa e shqyrtimit të buxhetit, Senida në Komitetin e saj mund të flasë akoma më shumë se si të synojmë ta lidhim pjesën e SDGs-ve me buxhetin, por te pjesa e mbikëqyrjes së përgjithshme, shoh rolin tuaj si koordinator kur flasim me auditin, Këshillin e Lartë të Auditimit, KLSH-në, që është një mekanizëm, i cili fare mirë mund të vihet në funksionin tuaj për të analizuar pjesën e arritjeve. Deri tani unë nuk e kam parë këtë institucion të dëgjojë apo të flasë ndonjëherë për SDGs-në.

Së dyti, flasim për INSTAT-in, ju folët deri tani për GENDER Importi dhe unë ju thashë që GENDER Importi është zemra e të gjitha SDGs-ve nuk është një SDG më vete, por është ajo që ne e quajmë *crossfade* pra ndërthur në çdo SDG tjetër, si elementi apo faktor tregues të GENDER janë të gjithë të përfshirë aty brenda. Kjo do të thotë sa e rëndësishme është për ju kjo aleancë, që të siguroni që pjesa e barazisë gjinore është e përfshirë.

A e keni menduar ndonjëherë të pyesni INSTAT-in sa i kanë të gatshme pjesën e datave të të dhënave *(nuk kuptohet.)*? Ju nuk mund të arrini të merrni vendime nëse nuk kemi të dhëna të mjaftueshme.

Te pjesa tjetër, mund të thosha se janë institucionet e pavarura dhe këtu flasim për Avokatin e Popullit, flasim për komisionerët, të gjitha institucionet që kanë detyrimin të japim llogari para jush se çfarë bëjnë për arritjen e të drejtave të njeriut, elemente që lidhin me pjesën e mbrojtjes së shtëpive, flasim për edukimin, flasim për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, flasim për çështjen e dhunës dhe barazisë gjinore. Pra, për të gjitha këto, ju si

përfaqësues të popullit keni të drejtën tuaj dhe detyrimin që ua jep edhe mandati që të kërkonti llogari.

Po të vini re, unë kam vënë në vija të përgjithshme se çfarë mundet të bëjë konkretisht një parlament, se si mund të angazhohet dhe nuk dua të hyj detyrimisht, sepse shumica i përmendën, por mund të ndalem vetëm te pjesa e mekanizmave parlamentarë. Unë e di që ju keni nga një pikë në çdo komision që merret me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, unë e di që është, siç e thashë më parë, një nënkomision i dedikuar për OJQ-të, që është nënkomisioni i Financave, që drejtohet nga zonja Mesi, por ndërkohë kemi elemente, të cilat çalojnë kur flasim për rolin tuaj aktiv në hartimin e ligjeve ... *(nuk kuptohet)*

Pra, unë e di që ka qenë një dëshirë shumë e mirë juaja që çdo projektligj që vinte në parlament, pjesa e parlamenteve të tjera në botë kanë atë që quhet *check list*, pra kanë një listë me pika për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, që kur hartohet një projektligj dhe kalon në komisionet përkatëse, pjesët lokale e marrin këtë *check list* dhe thonë dakord, po i marrim një nga një. Ka elemente të ndryshme që të kuptosh nëse ky projektligj shkon në përputhje me SDGs, se cila SDGs ndikon më shumë, si është pjesa e përfshirja së elementeve të aktorëve të tjerë të shoqërisë e kështu me radhë.

Këto janë sfidat që unë besoj se ju të gjithë do të doni t'i pohoni dhe t'i pranojmë si unë dhe ju, që ju doni të bëni shumë, zonja dhe zotërinj të nderuar që keni eksperiencën, por keni edhe barrën tuaj mbi supe. Sa herë që takohem me ju, unë ndihem kaq e lumtur që bisedoj për gjërat që ju doni të bëni, por jo gjithmonë gjërat varen nga ju, pra mundësitë janë jo gjithmonë aty ku duhet të jenë për arsye të ndryshme. Unë këtu kam përmendur vetëm disa. Pjesa e efektivitetit jo gjithmonë varet nga ju, mund të pengohet për shkak të burimeve të pamjaftueshme, shpeshherë ka mungesë të vullnetit politik, jo gjithmonë palët bien dakord për të hartuar një projektligj, sepse nisen nga interesat e tyre të ngushta partiake. Ajo që shoh se ndikon shumë në parlament është angazhimi juaj si deputetë në pjesën e planifikimit kombëtar. Pra, nëse ju duhet të bëni një rol shumë të rëndësishëm, është që (flasim për Axfordën e vitit 2023, por nëse qeveria nuk ka një), të kemi një vizion të caktuar se si do të shkojë deri në 2030. Nëse nuk ka një plan të duhur strategjik se si do të shkojë në 2030-ën për arritjen e këtyre objektivave, ky është një ngërç, të cilin ju si autoritet parlamentar keni të drejtën dhe detyrimin t'ia kërkonti qeverisë. Unë mund t'ju them vetëm se në fund të këtij viti ajo që quhet NSDI, pra strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim, përfundon dhe, duke filluar nga janari, qeveria nuk ka një NSDI të re. Ne, si OKB, po synojmë shumë ta ndihmojmë qeverinë të hartojë një NSDI të re, e cila në thelb do të ketë çështjen e integritit europian. Ne jemi ende në tetor, ju

kërkoj ndjesë që po e them kaq hapur, por nuk shikoj që puna për përgatitjen e NSDI-së të ketë nisur, ose të paktën ne nuk e kemi informacionin.

Pyetja që unë shtroj është se si mund të krijoni mundësinë që ju t'i reflektoni pikërisht synimet tuaja si parlamentarë dhe t'i lidhni ato me pjesën e planifikimit kombëtar që vjen nga qeveria. Ju takon juve të keni një rol shumë të rëndësishëm.

Pjesa e barazisë gjinore është thelbësore. Sihana foli për *markers*. Ne në raportimin tonë si OKB kemi dy lloje *markers*: kemi atë që quhet *humanright markers* dhe *gender markers* dhe çdolloj raportimi që bëjmë është nga zero tek treshi. Nëse ne nuk i kemi dy ose tre, mund të kthehemi mbrapsht për rezultatet që kemi arritur, pra nëse nuk kanë në thelb pjesën e të drejtave të njeriut dhe *gender politics*, për qendrën që ne raportojmë konsiderohen si të papranueshme. Po ta shikoni, përfshirja e dobët sistematike e qytetarëve dhe mungesa e barazisë gjinore në projektligjet që ju miratoni është një nga pyetjet.

E fundit, para se të kaloj te rekomandimet, është pikërisht çështja se çfarë mund të bëni ju si parlament. Ne me zonjën Mesi kemi menduar të bëjmë atë që quhet *tour chief*, i cili do të jetë si një udhërrëfyes që do të lidhë të gjithë pjesën e përshtatshmërisë së OZHQ-ve në parlament. Është shumë interesante, sepse, pak a shumë, çdo deputet që do ta marrë, pavarësisht nivelit se sa di dhe sa *aware* është për SDG-të është, e rëndësishme është ta lexojë dhe të kuptojë për çfarë mund të kontribuojë më shumë. Por ajo që është thelbësore, që unë doja të theksoja, është se nuk jeni vetëm ju që duhet të punoni, sepse në parlament ju keni një staf të tërë nga mbrapa; e kam fjalën për këshilltarët dhe për sekretariatit që keni ju, të cilët duhet të jenë shumë më tepër teknikë për sa i përket SDG-ve sesa ju, pra, ata janë ndihmësit tuaj që ju ta bëni punën siç duhet.

Së dyti, flasim për pjesën e vetëvlerësimit. Sihana tha se *gender code* shkon në një cikël, i cili është i mbyllur. Kështu është edhe konteksti i fillit të punës suaj si parlament për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Pra, ju hyni në monitorim, në shkurtim buxheti dhe në planifikim.

E fundit fare, kërkoj ndjesë që mora shumë kohë dhe uroj të mos jem bërë e bezdisshme, është që ju duhet të kërkonit fort dhe të konsultoheni në fazat që ka qeveria për sa i përket planifikimit të zhvillimit kombëtar. Pra, nëse ju nuk informoheni në kohën e duhur, pra që në momentin që planifikohen qoftë strategjitë sektoriale, qoftë strategjitë ndërsektoriale, se pjesa e barazisë gjinore nuk mbetet vetëm te ligjet, por është e përcaktuar qartë në shumë strategji sektoriale dhe ndërsektoriale, që i implementojnë strukturat qeveritare... A jeni ju të përfshirë? Unë ngre një pyetje shumë të madhe, kështu që këtë përgjigje mund të ma jepni ju.

Për sa i përket pjesës së burimeve, duhet të kërkoni dhe të ngrini zërin që të keni edhe ju burime të mjaftueshme. Patjetër që pjesa e suportit vjen nga donatorët dhe, nga përvoja, ky duhet të jetë një synim që duhet ta nxisim edhe në të ardhmen.

E fundit është ajo që thamë për objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm, 16, ku koncepti i të pasurit një rol mbikëqyrës për institucione të ndryshme që ju i keni në varësi, mbetet një kusht thelbësor për arritjen e këtyre objektivave. Kaq kisha. Jam e hapur për pyetje dhe kërkoj shumë ndjesë që mora shumë kohë.

Shikoj që kanë ngritur dorën Milva dhe Senida, prandaj fjalën po ia kaloj Milvës, pastaj Senidës.

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë, Fioralba, për prezantimin që bëtë, por unë kam disa ide për të shtruar! Në fakt, dua të them që duhet të kemi parasysh se parlamenti shqiptar është një nga parlamentet e para që ka hartuar një rezolutë për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe e ka pasur këtë në vëmendje të veçantë, duke bashkëpunuar edhe me qeverinë në kohën kur zonja Mesi ka qenë zëvendëskryeministre. Shqipëria ka paraqitur raportin alternativ të *objektivave të zhvillimit, Milenium*, në Kombet e Bashkuara. Në atë kohë Kuvendi hartoi një rezolutë, ku pati çështje shumë të rëndësishme, të cilën e miratoi në parlament. Miratimi i rezolutës solli me vete dy procese shumë të rëndësime: e para, në mënyrë periodike të zhvillohen takime, për të kuptuar se ku po arrijnë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm për sektorë të ndryshëm.

E dyta, kjo u bë me ndihmën e organizatave të Kombeve të Bashkuara, si, për shembull, UNICEF-it, UNDP-së apo Bankës Botërore.

Tjetra, parlamenti ngriti një nënkomision të posaçëm për matjen dhe ndjekjen nga ana e parlamentit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Kryetare e këtij komisioni është zonja Mesi.

Mendoj se parlamenti i Shqipërisë është një ndër parlamentet që ka reaguar më shpesh për sa u takon objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Nga ana tjetër, kur hartojmë një projektligj, ne kemi diçka specifike në Rregulloren e Kuvendit, që projektligji i caktuar duhet të jetë jo vetëm i interpretueshëm për sa u takon parimeve të *acquis communautaire*, por edhe për sa u takon parimeve të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Zonjat, të cilat i falënderoj, në mënyrë të veçantë zonjën Hysi, zonjën Gjermani, zonjën Mesi dhe zonjës Bushka, morën një iniciativë për të parë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra dhe të hartuara nga parlamenti, nga momenti i rezolutës deri në dhjetorin e vitit të

kaluar, nëse e kishim të përfshirë objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me cilat objektiva do të lidheshim.

Besoj se parlamenti i Shqipërisë i ka marrë shumë në konsideratë punët për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ne po flasim për barazinë gjinore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të lidhura me barazinë gjinore. Duke filluar nga disa objektiva, mendoj se ka qenë zonja Gjermani, zonja Bushka dhe zonja Spahiu, të cilat e kanë pasur shumë në vëmendje pjesën e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, të lidhura me barazinë gjinore.

Në fakt, ndoshta edhe ju keni dhënë kontribut, por situata në parlamentin e Shqipërisë është që këto gjëra i ka marrë dhe i ka përfshirë realisht në punën e vet.

Mos harroni që stafi i parlamentit është i trajnuar për të kuptuar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Ndoshta do të duhet më shumë punë për të bërë interpretim, por ne nuk jemi në fazën ku mungon interesi politik. Nuk mungon interesi politik për këto gjëra dhe ekziston vetëdija politike.

Ndoshta në prezantim unë do të thosha se duhet të shtojmë një nxitje ose efikasitet më të lartë, për t'i kuptuar këto, por jo se ne nuk jemi në faza të marrjes në konsideratë të objektivave.

Nuk e di sa e ndihmoj diskutimin.

Zonja Mesi, ndoshta duhet të shtosh diçka, meqenëse kryeson këtë komision, por unë besoj se kemi bërë disa hapa përpara në këtë fushë.

Fjoralba Shkodra – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Para se t'i jap fjalën zonjës Mesi, nëse mundem, edhe unë, siç e nisa me prezantimin, vij para jush me një sfidë, dhe e kam të vështirë të flas për elemente të objektivave të zhvillimit, duke e ditur që ju jeni gra dhe burra me eksperiencë në këtë drejtim. Unë u mundova që në prezantim të mos jepja vetëm një kontribut të përgjithshëm, por një lloj ndjesie. Absolutisht, ju keni bërë një punë të shkëlqyer për arritjet tuaja dhe unë i përmenda të gjitha angazhimet tuaja deri tani, por ne duhet të pranojmë se ju si deputetë, por, edhe ne, nga ana tjetër, të jemi ajo që quajmë “*self decibely*”, pra, të shikojmë veten gjithmonë me sy kritik se çfarë mund të bëjmë më shumë.

Unë mendova të nënvizoja 2-3 elemente, për të cilat mendoj se parlamenti mund të bëjë më shumë, për planifikimin kombëtar, si dhe një angazhim më shumë për pjesën e angazhimit me strukturat, që ju keni në varësi, që të shikojmë një rol më të madh në këto struktura. Po ashtu, edhe idetë se si mund të jeni më afër qytetarëve apo grupeve në nevojë.

Absolutisht, unë jam krenare për punën që ka bërë parlamenti deri tani.

Faleminderit!

Fjalën e ka Senida dhe më pas zonja Hysi.

Senida Mesi – Përshëndetje, të gjithëve!

Ju falënderoj për prezantimet, si në pjesën e parë nga përfaqësuesit e OSBE-së, ashtu edhe në pjesën e dytë nga përfaqësuesit e UNDP-së!

Faktikisht, kjo është një temë që ngjall interes dhe tregon se kemi bërë shumë, por ka ende shumë për të bërë. Kur flasim për realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe specifikisht objektivin nr. 5, që është pjesë e axhendës së barazisë gjinore, tregon se hapat e ndërmarrë deri tani janë jo vetëm në linjë me pritshmëritë tona, por edhe në linjë me pritshmëritë e organizatave ndërkombëtare, që po na ndihmojmë të ecim në këtë proces.

Unë ndaj të njëjtin shqetësim, mendim, quajeni si të doni, me Milvën, për çfarë kemi bërë ne për axhendën 2030 dhe për realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Nga eksperiencia ime e mëparshme, në disa takime që kemi pasur deri në nivel të rajonit ballkanik, po krahasoj veten me 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. E them me krenari se Shqipëria sot ka ngritur të gjithë infrastrukturën, qoftë nga ekzekutivi me komisionin ndërministror, që udhëhiqet nga zëvendëskryeministri, edhe për pjesën e iniciativës, që unë e quaj një sukses të të gjithë aktorëve të përfshirë, qoftë të zotit Braja, nga kordinatorët rezidentë, dhe të të gjithë ekipin që ka punuar në Kryeministri, edhe ministri i asaj kohe, zoti Ahmetaj. Ngritëm diçka, që nuk besoj se e ka dikush në Ballkan, pjesën e *SDG Acceleration*, ku kemi krijuar një fond të posaçëm dhe të dedikuar pikërisht për të realizuar pjesët e objektivave, të cilat aktualisht nuk janë të buxhetuara në buxhetin e shtetit, nuk janë të buxhetuara as nga Dona & Partners dhe si rezultat kemi krijuar edhe një kolonë të tretë për të buxhetuar atë pjesë të NSDI-ve dhe jo vetëm të 17 objektivave, por edhe të nënobjektivave dhe të elementëve për secilin nga 17 objektivat, me qëllim që të ecim më tutje.

Përveç anës së ekzekutivit, krijuam edhe strukturën paralele shumë të dëshiruar nga i gjithë ekipi i punës, me një mbështetje totale edhe nga Kryetari i Kuvendit, zoti Ruçi, për të krijuar pikërisht elementin shumë të rëndësishëm atë të monitorimit, sipas të cilit parlamenti i Shqipërisë ushtron funksionin kryesor ndaj qeverisë dhe ekzekutivit. Ky monitorim nuk është vetëm për ekzekutivin. Ju e dini shumë mirë që janë edhe institucione të tjera të pavarura, të cilat kanë në dorë avancimin e axhendës 2020 – 2030.

Në lidhje me strategjinë, i bashkohem të njëjtit shqetësim që ne nuk kemi për momentin ende një draft final apo parafinal në lidhje me strategjinë për zhvillim dhe integrim për 5-vjeçarin në vazhdim. Unë kam kërkuar edhe në Komisionin e Integritit European, e dakordësuar edhe me kryetarin tonë të grupit parlamentar, që një strategji e tillë duke qenë nëna

e strategjive, nëse mund ta quaj kështu, sepse përfshin 2 elemente shumë të rëndësishëm, edhe zhvillimin, por edhe integrimin, të jetë, le të themi, një strategji që mund të aprovohet edhe në Kuvend, pra për të ngjallur debatin politik, brenda për brenda Kuvendit. Unë mendoj se pavarësisht forcave politike, pavarësisht se kush e qeveris Shqipërinë, po flasim për integrim. Kur flasim për zhvillim dhe aq më tepër për agjendën 2030 kalon mbi interesin politik, sepse është interesi kombëtar. Pra, nëse një strategji e tillë aprovohet në Kuvend, pavarësisht kompozimit të nesërm, pasnesër apo në dekadën e fundi të realizimit të objektivave, atëherë kontrolli apo monitorimi i Kuvendit për të realizuar këtë agjendë do të jetë një element shtesë. Mungesën e vullnetit nuk e pranoj, sikurse në lidhje me monitorimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, nga deputetët. Ndoshta në artikullim e sipër ne nuk përmendim që po monitorojmë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, por sigurisht që në komitete përkatëse, kur diskutojmë buxhetin shikojmë elemente të punësimit, elemente të varfërisë, elemente të edukimit, në komitetin apo në Grupin e Miqve të Fëmijëve, shikojmë axhendën e fëmijëve dhe se si fëmijët po integrohen apo le të themi po merren masa specifike nga ministria përkatëse, por duke monitoruar dhe nga parlamenti të gjithë axhendën 360 gradë edhe për fëmijët.

Për t'u ndalur pastaj edhe në elemente të tjera të monitorimit të të gjithë linjës dhe të të gjitha objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Ndoshta artikulli është diçka tjetër dhe për hir të kësaj ne kemi planifikuar edhe me UN-in një *tour kids*, nëse mund ta quaj kështu, për një kuptueshmëri më të gjerë, edhe të deputetëve, për objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ne jemi në diskutim edhe me ministren për Marrëdhëniet me Parlamentin që në momentin kur projektligjet vijnë në Kuvend, të kenë në relacion një pikë të 10 të shtuar, çfarë dhe si ndikon ky projektligj për axhendën 2030 dhe pse jo edhe për *gender*, për sa kohë ne flasim me kaq zell dhe me kaq pasion, dhe e kemi në fokus të axhendës tonë apolitike dhe në fokus të axhendës tonë apersonale, një element të tillë, me qëllim që ne jo thjesht të monitorojmë, të kontrollojmë, por të realizuar atë çfarë ne vullnetarisht kemi pranuar.

Një element shtesë që dua të them, është puna që kemi bërë me INSTAT-in, i cili është një institucion i pavarur, performanca e të cilit monitorohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Është bërë një punë e shkëlqyer në lidhje me matjen e shumë komponentëve të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, ato që maten ose ato që ne kemi mundësi të masim. Besoj se një komponent i tillë do të ndihmojë shumë edhe në pjesën e matjes jo vetëm të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, por edhe në aspektin e balancës dhe të barazisë gjinore.

Fioralba Shkodra – Faleminderit, zonja Mesi për mendimet shumë të vlefshme!

Faleminderit për të gjithë kontributin që keni dhënë ju dhe Milva!

Fjala për zonjën Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Shkodra!

Ju kërkoj ndjesë që po ju dëgjoj nga celulari, sepse nuk munda të hyj nga sistemi. Më lejoni t'ju falënderoj për organizimin e këtij aktiviteti bashkë me aleancën e grave deputete. Kam ndjekur me vëmendje prezantimin e bërë nga zonja Nebiu, dhe pa dashur të përsëris atë që tha kolegja Ekonomi dhe kolegja Mesi, mund të theksoj se Kuvendi i Shqipërisë ka bërë një punë të lavdërueshme në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, sikurse po bën edhe për një parlament me ndjeshmëri gjinore.

Zonja Mesi përmendi disa nga objektivat dhe masat e marra, por unë dua të vë në pah që, krahas nënkomisionit të krijuar enkas dhe mekanizmit ndërinstitucional, ne ndryshuam edhe Rregulloren e Kuvendit. Në rajon mund të jemi ndër parlamentet, që objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm i kemi vënë si kusht për të shoqëruar relacionin që shoqëron projektligjin dhe që analizohet si nga relatorët edhe nga këshilltarët, që asistojnë relatorët në hartimin e raporteve.

Ajo që dua të theksoj është që ka nevojë për një forcim të bashkërendimit të punës së qeverisë dhe Kuvendit, por më shumë duhet asistuar qeveria, me qëllim që në relacionet ose në raportet e vlerësimit të indikatorëve të ketë një shprehje më të qartë të treguesve sipas objektivave, pasi shpesh këtë gjë ne e bëjmë vetë. Pra, mendoj që edhe ju, si një nga partnerët e qeverisë, duhet të fokusoheni më shumë në këtë aspekt, që raportet, ose relacionet, që shoqërojnë projektligjin dhe që vijnë në Kuvend të kenë disa tregues dhe të bëjnë lidhjet me objektivat. Për ne ka qenë një punë disi më e madhe, pasi duhet t'i nxjerrim vetë dhe shpesh këto gjëra mungojnë. Në këtë kuadër mendoj se secili mund të ketë përmirësime, por Kuvendi ka bërë më të mirën në kushtet kur ka pasur mungesë të metodologjisë, ose të indikatorëve se si Kuvendi mund ta matë këtë.

Nëse ju kujtohet, zonja Shkodra, në shumë takime me zotin Braian, unë e kam kërkuar këtë gjë në emër të Kuvendit për institucionin tuaj, që keni (*nuk kuptohet*) shumë të madhe në këtë fushë, që deputetët për objektivat parësore për qeverinë shqiptare, të kenë një udhëzues, një metodologji me indikatorët se si mund të bëhet *check-list* për të parë nëse projektligji vjen në përputhje me një nga 17 objektivat, që përmban Agjenda 2030. Kjo është e domosdoshme sidomos në kushtet e sotme, kur për shkak të COVID-19, shumë vende, jo vetëm Shqipëria, pritet të bëjnë hapa jo të kënaqshme në lidhje me përmbushjen e objektivave të Agjendës 2030.

Faleminderit!

Fioralba Shkodra – Shumë faleminderit, zonja Hysi!

Me të vërtetë ju bëni publike dhe reflektoni gjithmonë atë çfarë që keni bërë si parlament dhe gjithmonë në vjen ndër mend ajo për të cilën keni folur, por edhe aksioni dhe

veprimet, duke mbledhur përherë gratë, të cilat janë (*nuk kuptohet*) e kështu me radhë, që të punoni të gjitha bashkë, duke pasur parasysh që edhe ju nuk e keni të lehtë, sepse punoni vetë, ndërkohë që ndihma që keni, ajo që ju pamendët në prezantim, jo gjithmonë është aty ku duhet, qoftë nga burimet njerëzore, apo financiare të parlamentit. Kështu që unë ju falënderoj, por dhe ju përgëzoj jashtë mase për të gjithë punën tuaj pasionante, që keni bërë për objektivat e zhvillimit e qëndrueshëm. Absolutisht që jam krenare ta përcaktoj edhe pjesën e raportimit që ju ngritët, është një gjë shumë më vend. Kur zonja Mesi ishte zëvendëskryeministre ne bëmë raportimin e parë si vend në OKB, ndërkohë deri në 2030-n kemi një raund të dytë ku mund të raportojmë në OKB, në atë që quhet *Regional Political Forum*, por siç bëjnë vendet e tjera, ata çdo vit ose të paktën, 1 herë në vit qeveria nxjerr një raport që quhet Raporti i Arritjeve dhe (*nuk kuptohet*). Kjo është një gjë që ne e synuam këtë vit, por këtë vit ishte COVID-19, ishin shumë faktorë, kështu që vitin tjetër ne si OKB synojmë të ndihmojmë departamentin në Kryeministri që mund ta realizojë këtë raport, sepse siç e thatë edhe ju është një raport shumë i mirë që ju shërben juve për shumë vendimmarrje.

Eglantina Gjermeni – Fjori, shumë faleminderit!

Shumë faleminderit, të gjithë kolegëve që janë të pranishëm! Diskutimi u bë goxha aktiv dhe, me sa duket kemi nevojë të mblihdemi më shpesh që t'i diskutojmë gjërat.

Falënderoj secilën dhe këdo që ka kontribuar!

Është e vërtetë ajo që thanë koleget parafolëse, nuk dua t'i përsëris, por i falënderoj jashtëzakonisht për të gjithë kontributin që japin çdo ditë, pasi ne nuk e ngremë shumë zërin dhe nuk i bëjmë shumë të dukshme ato që bëjmë, por realisht në komisione me pyetje, me diskutime, me diskutimet në seancë, përmenden objektivat në lidhje me projektligjin, pyeten ata që përfaqësojnë qeverinë për të diskutuar ligjet e tjera me radhë, por nuk besoj se ishte ky thelbi i gjësë sot, ishte më shumë se si mund të krijojmë një sinergji të mirë mes objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm bashkë me barazinë gjinore dhe se si këto dy çështje, që janë kaq të rëndësishme, të mund t'i bëjmë pjesë të çdo nisme ligjore, të çdo aktiviteti, të çdo diskutimi dhe çdo monitorimi që bëjmë. Them që kemi një fillim shumë të mirë të punës, sepse kemi vullnetin politik, kemi përgjegjshmëri dhe profesionalizëm nga kolegët dhe koleget, të cilët jo vetëm e kanë votuar rezolutën, por e ndjekin zbatimin e saj.

Edhe unë jam dakord me atë që tha kolegja Hysi, sa i takon harmonizimit të punës sonë me qeverinë, domethënë gjithë kjo pjesë e ndërhyrjes nuk mund të bëhet vetëm nga parlamenti, apo vetëm nga qeveria.

Diku ti Fjori the që duhet patjetër që parlamenti të kërkojë të jetë i përfshirë që nga fillimi i punës në të gjitha nismat që ndërmerren, qofshin ato ligjore, apo procese, që janë

vendimmarrëse. Ne nuk duam që t'i kemi në parlament në momentin kur ato vijnë, duam që vërtet të marrim një informacion, që të kontribuojmë modestisht gjatë procesit. Do të na ndihmonit shumë edhe ju, edhe OSBE-ja që me mjete praktike, me *tools*, që u përmendën, si t'i realizojmë.

E para, dua ta ritheksoj që vullneti politik ka qenë dhe mbetet maksimal, ndryshe ne nuk do të ishim as në këtë trajnim, as do të kishim miratuar rezolutën të gjithë njëzëri, jo vetëm për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, por edhe për dhunën në familje. Kjo tregon se realisht vullneti politik është aty, u krijuan nënkomisionet, apo të tjera me radhë. Ajo që mbase neve mund të na mungojë dhe kërkojmë ndihmën tuaj është që në momentin kur ju ndihmoni qeverinë, ministrinë respektive, me nisma konkrete ligjore, me ekspertizë vendase apo të huaj, duhet patjetër të përfshihet edhe parlamenti, nënkomisionet specifike apo komisionet specifike, të cilat të jenë të informuara dhe të kontribuojnë shumë fort.

Në qoftë se ju i ndiqni proceset e ligjeve që diskutohen në komisione, e shikoni që vërtet diskutimi është super i zjarrtë dhe me këndvështrim edhe gjinor, nga kolegët dhe kolegët, edhe nga zhvillimi i qëndrueshëm. Them që na është bërë si pjesë e procesit. Duhet patjetër ta theksojmë këtë komponent të monitorimi, të mbikëqyrja e rolit të parlamentit.

Çdo praktikë pozitive e vendeve të tjera do të na ndihmonte, por duhet të jemi edhe pak krenarë për gjithçka që kemi arritur në kushte jonormale, me një opozitë të larguar nga parlamenti dhe të ardhur të tjerë, në kushte tërmeti, pandemie e të gjitha me radhë. Besoj se, në qoftë se vërtet matet me indikatorët, që i përmendëm edhe në prezantimin e parë, edhe tani, vërtet anohet nga pozitivja. Ne jemi më kërkues dhe duhet ta përmirësojmë, prandaj duam edhe ndihmën tuaj.

Faleminderit!

Sihana Nebiu– Faleminderit të gjithëve!

Meqenëse jemi drejt fundit të sesionit, faleminderit për diskutimin dhe ndjekjen me vëmendje!

Qëllimi i sesionit të sotëm ishte thjesht një retrospektivë se çfarë është *gender marker*-i dhe se si mund t'i institucionalizojmë SDG-të, duke kaluar nga një perspektivë se çfarë janë dhe si mund t'i përforcojmë.

Në asnjë moment nuk kisha dashur të merret si kritikë, përkundrazi, unë jam shumë krenare me të gjitha arritjet dhe më të gjithë hapat që parlamenti i Shqipërisë ka bërë. Shumica e gjërave janë duke u implementuar momentalisht, por janë sporadike dhe nuk janë të institucionalizuara. Faktikisht, eksperiencat janë, ndoshta nuk ka shumë nevojë për eksperiencat të jashtme sesa të përmbledhim ato që i kemi të brendshme, të krijojmë një plan konkret se si

të implementojmë dhe të fillojmë në mënyrë sistematike t'i mbledhim të dhënat dhe të raportojmë për çështjet për të cilat folëm.

Kështu që e falënderoj edhe zonjën Mesi! Në qershor apo në korrik shkurtimisht folëm se si mund të bëhen këto në aspekte konkrete.

Besoj se hapi i ardhshëm do të jetë që të jemi në kontakt më të ngushtë edhe me stafin dhe të fillojmë të veprojmë në zhvillimin hetues apo të mjeteve, të cilat parlamenti do t'i përdorë dhe do të jenë në kordinim edhe me ekzekutivin dhe me struktura të tjera. Realisht, e thashë edhe më parë, nuk duhet punë ekstra, por thjesht duhet vetëm të ndryshojmë pak strategjinë se si qasemi dhe në periudha të caktuara t'i japim vëmendjen, që në fund të korrim rezultatin që presim.

Kështu që me këtë do të kisha dashur ta mbyllja.

Jemi duke përgatitur edhe një pyetësor shumë të shkurtër, që do të na japë *feedback*-un tuaj për sesionin e sotëm, por besoj se do t'jua dërgojmë me një *link* dhe do t'ju marrë vetëm 2-3 minuta kohë. Më pas do të jemi në kontakt.

Zonja Gjermani, shoh se doni të thoni diçka.

Eglantina Gjermani - Kam vetëm një fjali të fundit. Kërkoj ndjesë!

Meqenëse përmendët pyetësin, mbase mund ta shkruaj edhe aty, do të sugjeroja që radhën tjetër, kurdo që të mblidhemi për të diskutuar një *follow up*, gjërat t'i kemi shumë më konkrete: parlamenti, komisionet në Shqipëri, dhe secila nga koleget apo kolegët ka mundësi të ndajë përvojën e vet dhe mund të përzgjedhim 3 apo 4 përvoja konkrete, t'i diskutojmë edhe me komisionet e tjera, për të parë se si e kemi realizuar në praktikë dhe si mund ta replikojë parlamenti në të gjitha komisionet. Them që kjo do të jetë shumë e dobishme, sepse edhe ne, duke vrapuar gjithë kohën, nuk kemi mundësi ta ndajmë këtë informacion me kolegët e komisioneve të tjera. Do të ishte shumë mirë në qoftë se do ta bënim këtë gjë. Janë gjëra në dukje të vogla, por që kanë impakt.

Faleminderit!

Sihana Nebiu – Shumë faleminderit!

Pasi u rilidhëm pas një kohe në këtë sesion, ideja ishte thjesht që ta mbajmë në mënyrë më të përgjithshme, ndërsa herët e tjera do të kemi hapa konkretë apo detyra konkrete, të cilat do të kontribuojnë hap pas hapi që të arrijmë vizionin që kemi për barazinë gjinore dhe për përmbushjen e SDG-ve. E thashë edhe më parë, jo domosdoshmërisht nuk janë duke u bërë, por mund të reflektohen, në mënyrë që të jenë më të dukshme punët që jemi duke bërë.

Prandaj edhe ju, edhe ne, jemi këtu, që së bashku të ndihmojmë që t'i realizojmë këto qëllime.

Kështu që ju faleminderit edhe një herë! Do të mbetemi në kontakt të mëtejshëm.

Mirupafshim!

Eglantina Gjermeni – Shumë faleminderit!

Elona Gjebrea – Faleminderit shumë dhe shpresojmë që herën tjetër të takohemi *live*!

Miranda Veliaj – Faleminderit, Elona!

Faleminderit, Tina!

MBYLLET MBLEDHJA